



REPUBLIK A E SHQIPËRISË
KUVENDI
Kryetarja

Nr. 4584 prot.

Tiranë, më 03.12.2024

U R D H Ë R

Nr. 84, datë 3.12.2024

PËR MBLEDHJEN E KUVENDIT NË SEANCË PLENARE, DATË 5.12.2024, ORA 10:00

Në mbështetje të nenit 7, pika 6, dhe nenit 27/1 të Rregullores së Kuvendit, bazuar në kalendarin e punimeve për periudhën 25 nëntor – 13 dhjetor 2024,

U R D H Ë R O J:

- I. Mbledhjen e Kuvendit në seancë plenare në datën 5.12.2024, ora 10:00.
- II. Rendi i ditës i seancës plenare është si më poshtë:
 1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të datës 3.12.2024.
 2. Njoftime.
 3. Interpelancë urgjente me Ministrin e Arsimit dhe Sportit, Znj. Ogerta Manastirliu, kërkuar nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike.
 4. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese me shkëmbim letrash të marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për projektin “Për përmirësimin e sistemit të shëndetësisë”, ratifikuar me ligjin nr.57/2015”.
 5. Projektvendim “Për miratimin e organikës dhe klasifikimit të pagave të punonjësve administrativë pas mbarimit të mandatit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”.
 6. Projektvendim “Për miratimin e organikës dhe klasifikimit të pagave të punonjësve administrativë pas mbarimit të mandatit të Komisionerëve Publikë”.
 7. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës.

III. Ngarkohen shërbimet e Kuvendit për publikimin e rendit të ditës të seancës plenare, njoftimin e anëtarëve të Kuvendit me anë të mjeteve të komunikimit elektronik, si dhe përgatitjen e dokumentacionit parlamentar që do të shqyrtohet.

IV. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.





SEANCË PLENARE PUBLIKE

E enjte, 5 dhjetor 2024, ora 10.00

RENDI I DITËS

Në mbështetje të urdhrit nr. 84, datë 3.12.2024 të Kryetares së Kuvendit, znj. Elisa Spiropali, rendi i ditës është si më poshtë vijon:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të datës 3.12.2024.
(Neni 44, pika 2, të Rregullores së Kuvendit)
2. Njoftime
(Neni 44, pika 3, të Rregullores së Kuvendit)
3. **Interpelancë urgjente me Ministrin e Arsimit dhe Sportit, Znj. Ogerta Manastirliu, kërkuar nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike.**
(Neni 80 i Kushtetutës, neni 97 e Rregullores së Kuvendit).
4. **Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese me shkëmbim letrash të marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për projektin “Për përmirësimin e sistemit të shëndetësisë”, ratifikuar me ligjin nr.57/2015”.**
(Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, e 121, pika 1, të Kushtetutës, dhe neneve 55 dhe 73-77 të Rregullores, shumicë absolute votash për miratim)

Pyetje

Shprehet nismëtari

Shprehet Komisioni përgjegjës për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë.

Dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Dhënie mendimi Komisioni për Ekonominë dhe Financat.

Dhënie mendimi Komisioni për Politikën e Jashtme.

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare)

Koha e votimit

5. **Projektvendim “Për miratimin e organikës dhe klasifikimit të pagave të punonjësve administrativë pas mbarimit të mandatit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”.**
(Në mbështetje të neneve 78, 179/b, pika 8, të Kushtetutës, neneve 18, pika 1, 70, pika 2, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën

e Shqipërisë, neneve 18 dhe 55 të Rregullores së Kuvendit.)

6. **Projektvendim “Për miratimin e organikës dhe klasifikimit të pagave të punonjësve administrativë pas mbarimit të mandatit të Komisionerëve Publikë”.**
(Në mbështetje të neneve 78, 179/b, pika 8, të Kushtetutës, neneve 18, pika 1, 70, pika 2, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, neneve 18 dhe 55 të Rregullores së Kuvendit.)

7. **Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës.**
(Në mbështetje të nenit 45 të Rregullores së Kuvendit: Çdo deputet mund të flasë jo më shumë se 5 minuta dhe nëse diskuton në emër të grupit parlamentar, jo më shumë se 8 minuta. Koha e diskutimeve për çështje jashtë rendit të ditës nuk mund të jetë më shumë se 60 minuta.)